

SPIRO DINAKU

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-7

852

*Kur shkoi gruaja me
shërbim*

SKICA
DHE TREGIME
SATIRIKE

854-2
852

SPIRO DINAKU

KUR SHKOI GRUAJA ME SHËRBIM

skica dhe tregime satirike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KUR SHKOI GRUAJA ME SHËRBIM

Në mbrëmje gruaja më njoftoi se të nesërmen do të shkonte me shërbim për dy-tri ditë në Tiranë.

Të them të vërtetën, ky lajm më bëri përshtypje, për të vetmen arsy se, që nga koha e martesës, këtu e pesë vjet të shkuara, nuk ishim ndarë asnjëherë. Ka patur raste që ajo ka shkuar me shërbim, por këto i ka kryer brenda ditës. Ndërsa vajtje-ardhjet tek prindërit e saj ose tek të mitë i kemi kryer, zakonisht, së bashku. Megjithatë qesh dakord që të nisej.

Dhe e nesërmja erdhi. Ndonëse preqatitjet kishin filluar që një ditë përpara, megjithatë, njëzet minuta para nisjes së trenit, ende nuk kishin përfunduar. Unë për vete isha gati dhe po prisja të niseshim për te stacioni i trenit. Zakonisht, pritet e tilla janë të mërzitshme, e aq më tepër kur janë brenda orarit të punës. Më së fundi çdo gjë mbaroi dhe, kur po dilnim nga shtëpia, dëgjoj gruan të më thotë.

— Siç e shikon shtëpinë ta kam lënë të fshirë, të pastruar e të rregulluar. Prandaj, ki kujdes! Kë-pucët, si gjithmonë, zbathi në korridor! Gjellët t'i kam lënë në frigorifer. Para se ta hash, ngrohe gje-

Ilën. Lekët për shpenzimet ditore i ke të sirtari i komosë. (Drita, gruaja ime, është ekonomiste dhe nuk të fal as dhjetë qindarka). Kujdes pra!

— Dakord! — thashë unë, që deri atëherë nuk kisha hapur gojën fare.

Tek stacioni i trenit Drita takoi dhe dy shoqet e saj, me të cilat do të nisej për në Tiranë.

*

* * *

Nga zýra atë ditë dola bashkë me shokët. Në fund të rrugës u ndamë. Unë u nisa për në shtëpi. Dritat ishin të fikura dhe atë moment unë u kujtova se Drita nuk ishte aty. Hapa derën dhe hyra brenda. Shtëpia pa Dritën më dukej si hani i Laze Buxhelit, si i thonë këtej nga anët tona.

E vërteta është se porosinë e parë e kreva. Kë-pucët i lashë në korridor. Doemos, porositë ishin akoma të freskëta. Vura gjellën të ngrohej dhe hapa televizorin. Duke parë filmin, e harrova gjellën e cila, pasi qe ngrohur, kishte filluar të valonte. Ngajqë më kishte marrë uria, fillova menjëherë të ha. Dhe ndodhi ajo që ndodhi. Goja më mbeti e hapur. Aksident. Unë dogja pjesën e sipërme të saj. Isha gati të vija ulërimën, po më vinte turp nga fqinjët. Ndaj desha s'desa, i vura një «gur zemrës», shtrëngova nofullat fort duke bërë kështu një mbyllje hermetike të gojës me qëllim që të mos hynte ajri i ftohtë. Kisha dëgjuar se e nxehtha del me të nxehthë. Fika televizorin dhe shkova të fle.

Kështu kaloi nata e parë.

Të nesërmen, kur vajta në zyrë, Elhami, shoku i zyrës sime, i habitur më pyeti:

— Pse je fryrë si gjel deti, a i vrarë?

— Nuk jam vrarë, jo, — iu përgjigja me zor — vetëm jam plagosur.

— Si the, more? — pyeti ai që, siç duket, nuk e mori vesh përgjigjen, ngaqë unë i flisja fjalët përgjysmë.

— Jam plagosur, vëlla, nuk jam vrarë. — po këtë herë ia shkrova në letër dhe, ngaqë Elhami, i çuditur, kërkoi hollësira, unë ashtu me të shkruajtur, ia shpjegova hallin.

...Edhe natën e dytë, si të parën, u ktheva herët në shtëpi. Isha ulur në divan dhe po bisedoja me një autor; po lexoja romanin e tij «Kur dola në jetë», kur dera trokiti fort. Kush të jetë ky që troket kështu, e nuk e sheh zilen elektrike që kam vënë në derë?!

U ngrita dhe hapa derën. Përballë meje qëndronin dy burra.

— Po ku je more nipçe! Kemi goxha prapa derës.

Ishin dy djemtë e dy xhaxhallarëve të nënës simë. U përshëndoshëm dhe pa e zgjatur fare, të dy, së bashku me dy palë këpucë që nuk u dukej fare ngjyra nga balta, u futën brenda. Njeri ndër ta, ai që ishte me moshë më të vogël (jo më pak se 49 vjeç), kërkoi t'i hiqnin këpucët. Po i madhi e «arsyeto» kështu:

— He, a derëbardhë, se nuk ka gajle, me se do merret Drita, se mos ka bagëti, a shpesë.

— Mirë thua! — fola dhe unë. Po në heshtje ia bëra të ditur Dritës, pafajsinë time, se edhe ajo vetë po të kishtë qenë, kështu do të kishte thënë. Dhe xha Çeloja, sikur të më kishte dëgjuar, ngriti këmbën e hodhi përmbi gju, dhe në takën e këpucës

shkundi çibukun. Pluhuri i duhanit ra mbi qilimi
— Ky duhani i sivjetmë, — tha, — éshtë i butë
dhe seç ka një erë.

Dhe vërtet dhoma u mbush me një erë duhani
vjeshtak.


— Karashtise më ca të fortë, a derëbardhë, —
e ndihmoi xha Teloja, — se del duhan soje! — Dhe
i dha një «hihi» me të qeshur.

Unë po mendoja ç'do t'u nxirrja për darkë. Nuk
u lodha shumë dhe llogaria u bë. Gjellët që më kish-
të lénë Drita do të më linin shëndetin, ca kokrra
vezë po se po dhe një kile raki. Po vallë, a do t'u
dilte, se si xha Teloja, dhe xha Çeloja e pinin rakinë
me opingë?

Ajo darkë shkoi si shkoi, dhe mua mu duk se
mysafirët u kënaqën.

Në mëngjes bilanci ishte ky: Produkte të gat-
shme zero, gjysmë të gatshme, doemos zero, se i hën-
gri edhe ato xha Teloja me xha Çelon. Buxheti: ak-
tualisht pesë lekë të reja, katër nga të cilat do të
prisheshin në mëngjes për t'u paguar kafet të ardhur-
ve, diferenca, një lek të ri, në xhep.

Përsa i përket lëndës së parë, në frigorifer kish-
te gjendje dhe bile, me kualitet të mirë, mish viçi,
zarzavate, gjalp, madje dhe peshk, po ato nuk gatu-
hen vetë, unë për të gatuar jam elifimatrak. Kështu
që edhe pse kishte, xha Telos me xha Çelon nuk i
hynin në punë, ata donin të hanin. Ata nuk kishin
ndërmend të iknin. U detyrova të nxjerrë mishin
nga frigoriferi dhe e vura në tenxheren me presion.
Por vetëm kaq, sepse më erdhi në ndihmë nënë
Kadeja që banon në katin e tretë. Shpëtova, thashë
më vete, jo vetëm nga të gatuarit por duhet të shkoj
dhe në zyrë, sepse jam vonuar plot një orë e gjys-



më.» S'e bëra të gjatë. Si i qerasa me kafe, u ndamë; unë për në punë, ndërsa ata do të shkonin tek një mik i tyre. Dhe ajo ditë shkoi si shkoi. Nënë Kadeja kishte gatuar për drekë e për darkë, ndërsa të nesërmen në mëngjes të dy burrat ikën. Dola dhe unë me ta për në punë. Kur po ndaheshim xha Teloja më porositi:

— Selam nuses, nipçë!

— Selam paç, xha Telo! Do t'i them sa të vijë.

Mbas orarit të punës u ktheva në shtëpi. Shtëpinë e gjeta të mbushur me jorganë e dyshekë, jastëkë e hi duhani, pjata dhe tenxhere të palarë. Rrëmujë shtëpia, bosh frigoriferi. Drita akoma në Tirana. Hajde, kusur, hajde! Sa gjë e madhe qenka gruaja në shtëpi! Ç'të bëja. Fillova të rregulloja shtëpinë me aq sa më vinte ndoresh.

Sapo kisha ngritur dyshekët dhe ajo rrëmuja e madhe s'qe më, kur nga poshtë dëgjova që thërrisin emrin tim. «Po kjo e thirrur?»

— Hajde se erdhën drutë!

Ishte karrocieri i komunales që kishte sjellë drutë, dhe për të zezën time, jo një, po tre racione. Shtëpinë e kam në katin e pestë. Megjithatë, në këtë drejtim nuk më mungonte eksperiencia. «Jë më në fund do të bëj një punë» — thashë me vete, duke patur parasysh që kur të kthehej Drita do të tregoja dhe unë diçka.

Dhe nisi beteja midis meje dhe një metri e gjysmë kubi dru. Lufta mbaroi në orën tre mbasdreke. Drutë kapitulluan pa kushte në gjendje të «arrestuara» dhe unë rashë i zalisur në divan në guzhinë. Kur u zgjova ishte natë. Fshiva sytë mirë, po prapëmbeti natë. Ndeza dritën dhe ora shënonte shtatë. Skisha ngrënë. Asgjë s'kisha të gatshme.

Fundja vendosa të gatuaja vetë. Ndeza furnellën me vajguri dhe mbi të vura tiganin më vaj ulliri; thashë të skuqja dy kokrra vezë.

Sapo isha ulur për të ngrënë, ndjenja uri, kur dëgjoj zilen e portës të bjerë fort. Hapa derën. Ishte Drita.

— Hë, ç'kemi? Si ja çove?

Unë nuk e zgjata shumë sepse kisha uri. U ula të haja, çudi, duket, nga që qeshë i uritur vezët po më shijonin. Drita më shihte dhe qeshte. Po qeshi fort kur unë fillova t'i tregoj «peripecitë» e mia.

V E N D I M I

Unë, shoku Lavdosh, mora një vendim shumë të rëndësishëm: «Këtej e tutje do ta ndihmoj gruan me të gjitha mundësitë» Vendimi u mor në heshtje. Dritës nuk do t'i thoshja gjë. Dhe këtë nuk e bëra se jam burrë fanatik, siç mund të më quajë ndokush, por, dreqi ta hajë, pesë lek burrëri i kam. E, përderisa është kështu, s'kam asnëjë arsyе t'ia them gruas vendimin. Puna vetë do ta tregojë.

Mbasi pyeta gruan në cilin dyqan e merrte bukën, u nisa menjëherë. Shitësja qe një grua e shkathët dhe klientët i priste me buzë në gaz. Mua m'u bë shumë qejfi nga ajo pritje dhe instiktivisht buzëqesha.

- Pse qesh, more shok? — m'u drejtua shitësja.
- Ashtu, kot së koti.
- Ç'dëshironi?
- Bukën, asgjë tjetër!
- Po, më falni, këto ditë keni ardhur në qytetin tonë?
- Jo, moj shoqe, kam kohë që kam ardhur!
- A, më falni, duket qenkeni martuar tanë? Familja e re ka halle.

— Moj motër, unë kam plot pesë vjet që jam martuar.

— Çudi! Dhe asnijëherë nuk të kam parë në dyqan? Duket këtë punë e paska bërë gruaja gjer më sot.

— Po, si urdhëron. I kemi detyrat e ndara. — u përgjigja dhe nuk e ngava më tej fjalën me shitësen se mendova «shpo të shpojmë dhe po i dalin lakinat byrekut».

— Sa u vonove, more burrë! — më qortoi Drita.

— Ishte duke u shkarkuar karroca e bukës, Drita.

— gënjeva pa dashje.

Në zbatim të këtij vendimi pas pak u nisa përmarrë mish. Në dyqan kishte njerez. Njerëzit në radhë prisnin që shitësi, një burrë i shëndoshë, të copëtonte mishin. Si mbaroi copëtimi, filloi shitja. Shitësi, si e peshonte mallin e merrte paratë, thërriste: «radhën kush e ka?» Unë shikova rrëth e rrotull se mos gjeja ndonjë të njohur, por, përfat të keq, asnje nuk pashë. «Dreqo punë, thashë me vete, të gjithë të njohurit e mi nuk ngrënkan mish, vetëm unë qenkat mishngrënës.» Iu luta njërit të merrte në radhën e tij, po ai ma preu:

— Mbani radhën, shok.

— Si urdhëron! — thashë dhe prita radhën e cilal kaloi shpejt se, të them të vërtetën, kasapi ishte shumë i shkathët.

— Nga je ti, or babam? — m'u drejtua shitësi, kur u gjenda ballë përballë tij.

Të them të drejtën, më erdhi turp dhe mallëkova veten që mora një vendim kaq të rendësishëm dhe të nxituar. «Po si dreqin nuk i mendova këto peripeci!» Nejse, tanë që i hyra kësaj punë nuk ishte mirë të térhiqesha që në fillim.

— Jam nga lagjja «Te ura e pérroit» — u pér-gjigja unë.

— Jo, more. — u tall shitësi i mishit, — qenke nga lagjja «Te ura e pérroit,-a?! Po si nuk e kemi parë asnijëherë zotërinë tënde nga dyqani, apo ke qenë beqar?

«Prapë doli puna e beqarllékut?!» murmurita me vete.

— Si the? — pyeti shitësi.

— Jo, more vëlla nuk jam beqar, po...

— Keni qenë ndarë pérkohësish me gruan dhe tashti jeni bashkuar sërisht. Bukur! Mirë fort! Ore, po pér hatër të fëmijëve, a derébardhë. Se, dëgjo këtu: c'faj kanë të vegjëlit! Ja, vjen fjala...

— Or shok, — i thashë kësaj here me të nxehur — po nuk jam ndarë kurrë me gruan! Kot flet zotrote?! Ne i kemi ndarë punët me gruan, ajo merrjeq me blerjen e mishit, kurse unë me të tjerat, tashti...

— Ndërruat portat, a! — u përgjigj shitësi më të qeshur.

— Merre si të duash, po, po deshe më peshod dy kg. mish! — i thashë prapë. Mora mishin dhe pa e përshëndetur desha të dal.

— Po kush je zotrote, se as emrin nuk ta mësuam? — më ndaloj shitësi.

— Jam Lavdosh Sefedini.

— Qofsh shëndoshë, o shoku Lavdosh! Gëzohem që u njohëm! E hëngsh mishin me shëndet!

— Faleminderit! — u përgjigja dhe bëra të dal duke menduar. «Të shohim, o Lavdosh vëllai, ku do të dalësh si e ke nisur. Po fundja me që e nise, bittise tanë se s'ka lezet!» Dola jashtë. Kisha pér të blerë vaj dhe sheqer. Në trotuar me bisht të syrit

pashë të kalonin dy shokët e mi. «Ndoshta nuk më shohin». — thashë dhe ktheva kurrizin. Mirëpo tentativa ime dështoi. Ata më kishin parë.

— Hajde, burrë, hajde! — më foli Sotiri. — Po qëndroke në radhë?! Bukur! Qenke emancipuar, mo-re qerrata!

— Ç'të bësh, — fola unë duhet të ecim edhe ne më kohën

— Jo, more, — u përgjigj Hamzaj — me kohën, a?! Ec, ore dreq, lëre radhën! Le të vijë Drita! Ç'do të bëjë ajo?

— Me të vërtetë, me se do të merret? — e për-forcoi edhe Sotiri.

— Ec, ore, se na ke lënë duet, kemi qenë trio dhe po qan bulevardi! Po këtë pak o çfarë e ke?

— Mish. — u përgjigja.

— Oj, oj, po kur qenke bërë për shtëpi?! Dëgjo këtu, Hamza! Ia paska mbledhur Drita, ia paska bërë rrup-sup!

— Jo, more, që kur kështu zotrote?! Ç'pate?! Ti ishte mirë, si të erdhi kështu?! — u tall Hamzai.

— Hë, hë se e ka sëmundjen të re dhe do t'i kalojë shpejt, — e shtyu më tej talljen Sotiri.

Unë heshtja, por e shihja që sa vinte dhe po e humbisja durimin, mirëpo, për fatin tim të mirë, më erdhi në ndihmë Hamzai.

— Ikim, Sotir, se me këtë nuk u marrkemi vesh sot. Mirupafshim! — thanë dhe ikën që të dy.

«Dreqi e mori, fola me vete, le gomari që na ngordhi po as mizat nuk të lënë rehat.»

U nisa për ku qeshë nisur.

Te dyqani i ushqimeve nuk kishte njerëz fare dhe unë shkova «drejtë e në thela», kur i thonë fjalës.

— Vaj ulliri, shoqe!

— Avash, more shok, se na trembe! — tha shitësja, vërtet e trembur.

Me të drejtë u tremb se unë e zura gafil. Ishte duke lexuar një libër, që, siç e pashë më vonë, mbante titullin «Kontabiliteti industrial». Dukej se vazhdonte shkollën.

Mirë bënte që lexonte, fundja kohën shfrytëzonte.

— Ç'deshe?! — tha shitësja si u përmend mirë.

— Vaj, moj shoqe, dhe sheger!

Së fundi, mora ç'kisha blerë, pagova lekët dhe po prisja që të merrja kusurin.

— Më falni, ju mos jeni burri i shoqes Drita?

— Po.

— Ua! Më raftë pika!

— Pse? — pyeta me habi.

— Po unë shoqen Drita e kam mësuese, më jep këtë. — dhe më tregoi «Kontabilitetin industrial».

Në shtëpi shkova gjithë gaz se fundja kisha kryer goxha punë. Nuk e di, po e vërteta është se ndieja një kënaqësi të veçantë! Edhe Drita më shikonte ndryshe. Sikur më donte më shumë. Ia tregova fill e pér pe peripecitë. Ajo queshte. Edhe unë qeshja.

— Ta kisha ditur, — tha Drita, — do të vija me ty të të prezantoja me shitësit dhe shitëset.

— Sa mirë do të bëje, o Drita. Po nejse kjo punë u zgjidh. Tani më njojin të gjithë.

DĒNIMET NË MUNGESË

— Dëgjoni këtu! Më shikoni mua! Ja, unë që jam në krye tuaj, kam patur përgjegjësira më me shumë përgjegjësi. Bile, përgjegjësia më e vogël është kjo që kam tanë, domethënë, drejtortllëku...

Kështu, zakonisht, e niste drejtori ynë ligjëratën e tij në çdo mbledhje, të cilat ne i bënim «të rralla», një në çdo ditë dhe «të shkurtëra», më e shkurtëra dy orë.

Shoku Sherif, kështu quhej drejtori ynë, ishte njeri i gojës. Tërë ditën, po ta lije, fliste e fliste sa ta bënte kokën dhallë. Por ama nuk harronte që të vinte në fillim fjalën e tij aq të dashur «Unë».

— Unë iu kam thënë, shokë e shoqe, se plani është plan dhe këtë të uruar plan nuk do ta realizoj vetëm unë. Ama, kështu si e keni nisur ju dhe po të mos jem unë, plani na lë shëndenë. Unë flas shqip: në mëngjes vij i pari unë, çekun e rrugave e firmos unë, në mbledhje shkoj unë, për punën prodhuase përgjigjem unë, me furnizimin merrem unë, me shpërndarjen, sigurisht, unë, me normimin e punës unë, me planifikimin unë, me kuadrin domosdo që duhet të merrem unë, pra, po të mos jem unë, ju nuk bëni asgjë. Me sa shoh unë, ju vetëm

për murgjér bëni, mirëpo ata të shkretë manastirë u mbyllën, dhe ju më keni zënë derën mua. Mirë ju, po unë nga t'ia mbaj? Po edhe unë, shokë e shoque, kam fajet e mia, sepse nuk kam pushuar në vend ndonjërin prej jush. Sa herë më kanë thënë ata lart: «Pusho, more shoku Sherif, nja katër a pesë!» Po unë jam zemërmirë, dhe jo pesë po as dy nuk kam pushuar... Mirëpo kupa mbushet dhe unë, ashtu me lotë në sy, do të pushoj një, ndoshta edhe dy, e pse jo edhe tre.

— Po ne pesë jemi gjithsej, shoku Sherif! — guxoi e tha një nga shokët e administratës.

— Le të jeni edhe gjashtë, unë të pushoj. Dhe, po të pushova unë, nuk të zënë këmbët dhé në këtë tokë, e more vesh? — dhe u drejtua nga shefi i planit, thua se atij ia kishte vënë syrin.

— E paskeni zënë me mua, shoku drejtor! — foli me ton shefi planit.

— Po jo me ty, more djall! Ti je më i miri nga të gjithë. Ti punon, ti sakrifikon, ti ngrihesh herët dhe vjen në punë bashkë me mua. E kush më mbetet mua, po të të pushoj ty?

Pranë shefit të planit kishte zënë vend shefi i furnizimit, i cili dukej i nervozuar nga qëndrimi i drejtorit.

— Siç duket, radha më erdhi mua, — foli ai.

— As ty jo, more Sulçe. Se ti, Sulçe, ja, ta them në sy unë, je njeri i sakrificës, operativ, e shikon punën në perspektivë, njeri që i lë kalamajtë fjetur në mëngjes dhe i gjen fjetur në darkë. Bile, kam mendimin të të lavdëroj këtu para kolektivit, dhe ta marrin vesh të gjithë sa janë këtu në mbledhje se djalë më punëtor e më të sjellur se ti s'kam.

— Si po i shoh bathët e priftit, — foli me zë



2 - 124



të mekur shefi llogarisë, — llogaria del që opingat t'i mbath unë. Mirëpo unë...

— Ulu, more Braçë, ulu, se na bëre për të qarë! Ndërmarrja pa ty është si peshku pa ujë. Se ju e dini mirë, more shokë e shoqe (ndonëse në sallë nuk kishte asnje shoqe, por vetëm ne pesë shokë) por po jua them edhe një herë se para tetë vjetësh, kur nuk kishim shokun Braçë në ndërmarrje, ishim beterr, more shokë, beterr. E dini kujt i thonë beterr? Ja: banka na bllokonte; debitor privat kishim, magazinat qenë rrëmuajë, me koston dilnim si mos më keq, fitimin nuk e njihnim fare, e ç'tu them unë më përpara. Po shyqyr shokut Braçë dhe pikë muhabitet thoni!

— Po të jetë se këta shokët qenkan kaq të mirë, shoku drejtor, më duket se plumbi do të më zërë mua. E sa të më zërë për keq, më mirë po largohem vetë, — foli kësaj radhe shefi i shpërndarjes, i cili kishte plot njëzet vjet që e ngrohte atë karrige dhe i vinte keq të gjorit ta linte tani që i qe afruar pensionit.

— Hajde, Velo, hajde! Kush guxon të të pushojë ty, more?! Ti je organizatori ynë. Kthehesh i lodhur e i këputur dhe lodhjen nuk e tregon aspak. Qëndron i papërkulur. Si një shtyllë betonarmeje je në degën e shpërndarjes. Ja ku po ta them në prani të të gjithëve: ty nga kjo karrige nuk të lëviz njeri, jo!

— Me sa duket shpëtuam edhe këtë herë, — thashë edhe unë një fjalë andej nga fundi.

— Kush foli? — pyeti shoku Sherif.

— Unë fola, shoku drejtor, — u përgjigja nga e keqja.

— Mirë bëre që fole. Ja ku po ta them unë edhe

ty. Asnjëri nuk të luan ty nga vendi. Të hidhet përpjetë kush të dojë, se, fundja, punën tënde e kryen mirë. Dhe ulu e mos fol më! Vëri pikë edhe ti muhabitet!?... — More po ai, Vironi, ku është, xhanëm? — foli drejtori si u mendua.

Ne pamë njëri-tjetrin, në sy dhe nuk dinim si t'i përgjigjeshim se, qështë e vërteta, Vironit nuk ja gjeje dot adresën. Ai, si shef transporti, merrej me shoferët dhe ku ngrysej nuk gdhihej. Mirëpo shoku Sherif donte përgjigje.

— Ku është, more, po ju them, dëgjoni apo jo?

— Me siguri me shoferët, shoku Sherif, — foli Braçja, — kontrollon, udhëzon, shikon, udhëton...

— Mos paftë të nesërmën! — u nxeh shoku Sherif. — Mbas shoferëve! Pse kanë frikë shoferët të shkojnë vetëm?! Ja ku po jua them unë, shokë e shoqe, ai është i padisiplinuar, njeri anarhist, pijanik dhe gënjeshtar. Unë e kam këshilluar me dhjetëra herë po nuk më ka dëgjuar. Ama, unë i kam dalë borxhit. Ndoshta, ka ndërmend të më hipë në qafë, po unë, shokë, nuk e lejoj! Se ua them hapur unë, kam patur përgjegjësira më me përgjegjësi dhe i kam drejtuar mirë, shokë, mirëpo do thoni pse erdha këtu. Dakord! Ka batica dhe zbatica. Nejse, prapë sot kam përgjegjësi dhe s'më lejohet të jem indiferent ndaj Vironit. Ku është shefi i kuadrit? Dëgjove, Stefanaq, mbaje shënim: Viron Daçi të pushohet në vend me këtë motivacion: «Njëri dembel, e rrëmbe rutina e ditës, nuk i ndjek problemet deri në fund, është arrogant me punonjësit...» Mjaft, mjaft të tjerat i bisedojmë edhe një herë bashkë! Dakord?

Ne pamë njëri-tjetrin në sy dhe na vinte pëtë qeshur. Po, po, pëtë qeshur, sepse nuk është

hera e parë që drejtori ynë pushonte në vend në mungesë. Ndërsa në dhomë ishte qetësi, u dëgjuau një trokitje në derë.

— Hyr! — foli drejtori tërë hundë e buzë.

Dera u hap. Ne pamë hundën e shokut Viron, e cila i paraprinte edhe këtë herë si në çdo betejë të kaluar. Pastaj Vironi u fut së bashku me cigaren që mbante në gojë vazhdimisht.

— Me leje, të marr pjesë, shoku drejtor, ndonëse me vonesë?

— Hajde, more djalë! Ç'qenke bërë kështu për ibret?!

— Jam bërë pér ibret, shoku drejtor. Kam gjithë natën pa gjumë. Na mbeti një makinë në baltë. Tani në miengjes morëm një traktor dhe mezi e nxorrëm. Siç e shihni edhe vetë, sa po mbaruam punë.

— Të lumtë, o Viron! Ti je i palodhur...

— Jepi, shoku drejtor!

— Kush foli? — tha shoku Sherif.

— Unë, — tha një shef tjetër i shkurtër në një qoshe.

— Mos na e pre fjalën!

— Jo, jo, jepi, shoku drejtor!

— Njeri operativ, që i ndjek problemet sipas rëndësisë dhe karakterit të tyre. A s'ju thashë unë, shokë, që Vironi nuk mungon kot në mbledhje? Do të ketë një hall. T'jua them troç, shokë e shoqe: kam qenë në përgjegjësira më me përgjegjësi, kam patur dhe kuadro të tjera në drejtim, por jo si Viron Daci. Më falmi, dhe ju të tjerët bandilla jeni, po Vironi ha bukë veç, keq të mos u vijë. Ku është shefi i kuadrit, ku u zhduke, more Stefanaq? Merr shënim, të lutem, hë! «Të shënohet në dokumentet

e shokut Viron se, përveç të tjerave, është edhe njeri i sakrificës, bile, le të thuhet atje se në raste, që janë jo të rralla, detyrohet të flerë edhe jashtë!»

— Shoku drejtor, po ajo e...?

— Të them troq unë ty. Bëje këtë që të them unë, dhe vëri pikë këtij muhabeti!

— Shoku Sherif, — u drejtua më së fundi shefi i kuadrit, — është e udhës që gjërat t'i thuhen tjetrit në sy edhe jo prapa shpine, si bëni ju!

— Ohu! Të bëheshin tërë ato që thotë shoku drejtor, asnjë nga ne nuk do të bënte më hije në këtë ndërmarrje, — fola unë. — Po do t'i vijë radha dhe shokut Sherif.

KASAPI I LAGJES SIME

— Burrë, — më tha gruaja, — mishi mbaroi
dhe miqtë nuk kanë ndër mend të luajnë nga vendi,
se kanë marrë lejen e zakonshme.

— E si t'ia bëjmë?

— Ç'të bëjmë?! Merr trastën dhe vrap e te dy-
qani i mishit!

Pa e zgjatur asnjë milimetër, rrëmbeva një tras-
të dhe mora rrugën nga dyqani i mishit. Ecja me
vrap. Në mendje më ishte fiksuar mishi i varur në
çengela dhe pranë tij kasapi ynë i dashur, i quaj-
turi Myslim, i cili, duke qeshur, i thoshte klientit:
«Ku e do, i dashur, mishin, këtu, apo këtu? Urdhë-
roni!» Dhe e priste mishin atje ku donte klienti. Mi-
rëpo, ky mendim kaq i bukur u zëvendësua nga një
tjetër i llahtarshëm. Kur zura vend në radhë, dë-
gjova shitësin, Myslymin, që, me hanxhar në dorë,
iu drejtohej klientëve: «E doni? Jo! Udhë e mbarë
u qoftë! Këtë kam, këtë jap. Po të pëlqeu, merre,
or babam! Nuk të pëlqeu, mbathja nga ke ardhur!
Hajde, kush e ka radhën tjetër? Si the ti shoqe? Pse
e fute brenda atë kofshë mishi?! Pse, mos deshe t'i
marr leje zotrisë sate?! Shiko mbylle gojën, të kam
rixha, se unë të njoh mirë se kush je! Taqo, bjeri

lekët! Na mishin! Hajt, shëndet nga shtëpia! Pse ia dhashë pa radhë? Ore, po qenkeni fare ju, or ju mbylltë! Po Taqoja është furxhi, unë kasap. Po helbete, or byrazer...»

Vendosa trastën mbi banak dhe hodha vështrimin andej nga shikonin dhe paraardhësit e mi. Fjala ishte për mishin që sa po vinte e po mbarohej. Duhej të prisnim furnizimin. Kushedi sa do të vonohej. Or vëlla, po kisha miq në shtëpi dhe më duhej të nxitoja. Ata donin të hanin. Ishin me leje, jo shaka.

Nga radha e grave nuk kishte fare njerëz. Dola jashtë me shpresë se mos takoja ndonjë të njojur. Po, për be, asnë nuk më doli përpara. Nuk i thonë kot atij llafit: «Kur e do, nuk e gjen, kur nuk e do, të pengon këmbët.» Dhe ja, kështu mishi mbaroi dhe makina e furnizimit ende nuk po dukej.

Po halli?! Të gjithë, sa ishim, po shikonim njëri-tjetrin në sy, ndërsa disa u shpërndanë. Ndonjë bleu mish pule. Kështuqë në dyqan mbeten tre vetë, ne që donim, me sa duket, mish viçi. Ç'të bësh, do të prisnim! Kasapi Myslym ngaqë s'kishte ç'të bënte, filloj të rregullonte lekët për t'i dorëzuar në arkë.


— A thua do të vonojë furnizimi! — pyeti Kadriu, një punëtor i Tecit, që priste me ne.

— S'e di, — tha Myslymi duke ngritur vetullën e djathtë lart në shenjë pakënaqësie.

— Myslym, shih se mos kesh ndonjë copë andej nga frigoriferi!? — u hodh një tjetër. — Se tre vetë jemi.

— More vëlla, nuk kam, se, po të kisha, nuk e mbante Myslymi. Më vjen shumë keq bile, që ma thoni!

Në këtë kohë në dyqan hyri një grua, zonja Mensude, e shoqja e doktorit. Ajo na vështroi mirë



të gjithëve dhe, megjithëqë na njihite, nuk na foli fare. Ndërsa kasapit Myslym i buzëqeshi. Gruaja e doktorit pa ç'pa, dhe bëri të largohej nga dyqani.

— Zonja Mensude! — thirri nga prapa kasapi Myslym.

Gruaja u kthyte po, ç'është e vërteta, nuk foli.

— Ju lutem, merreni mishin që keni lënë në frigoriferin e dyqanit tim, mbasi, më falni zonja Mensude, frigoriferi ynë nuk punon në rregull dhe është rrezik t'ju prishet mishi!

Zonja Mensude buzëqeshi.

— Posi, se dhe frigoriferi im u lirua. Po mund ta rregulloj atje.

Kasapi u fut në frigoriferin e dyqanit dhe doli që andej me një kofshë të prasme viçi. Ai e peshoi.

— Katër kile plot. Më është bërë zakon kjo punë. E ç'qe nevoja ta peshoja? Ha, ha. S'harrohet zanati, jo, — deshi të na e hidhte kasapi.

Gruaja e doktorit deshi të hapte çantën, po Myslymi s'e la.

— Doni të më jepni borxhin? Nesër, zonja Mensude, nesër se sot i numërova lekët, mos më ngatërroni, ju lutem! — foli kësaj here, jo pa frikë Myslymi.

Dhe vërtet kësaj here Kaariu i toli prerë zonjës së doktorit.

— Mos u largoni, o zonja Mensude!

Gruaja u kthyte dhe e pa rreptë atë që i foli.

— Më falni, kush jeni ju që më ndaloni?

— Një punëtor. Ja kush jam.

— Atëherë, me ç'të drejtë më ndaloni? — u krekos «si kaposhi i Muços», që i thonë, zonja Mensude. «Shyqyr, — thashë me vete, — që u gjend një

burrë, që ia mblođhi kasapit Myslym se ky lëmë do shinte gjithmonë.»

— Kush ta dha këtë të drejtë që të rezervosh mish për të afërm e të njohur?!

Kasapi Myslym uli kokën gjoja u turpërua. Po Kadriu nuk jepej. Ai e njihet mirë Myslymin që deri dje kishte qenë kasap privat. Nejse ç'ta zgjatim, mishi i zonjës Mensude..., më falni, mishi që kishte ruajtur kasapi u vu në shitje, ndonëse atë kohë arriti dhe furnizimi dhe njerëz të tjerë vërshtuan në dyqan.

Pas ca ditësh kasapin Myslym e takova duke prashitur lulledielli në një bllok të madh të fermës. E kishte marrë Kadriu me vete.


FESTA E KUAJVE TË RINJ

- Epo gëzuar! — uroi Toli.
— Gëzuar dhe shyqyr që shpëtuam! — ia ktheu Loli.
— Lindëm për së dyti, jo shaka! — foli këtë radhë Coli.
— Jo, po na mori shpirtin, xhanëm, ke parë ti kështu?! Sapo vuri ai këmbët në atë zyrë, ne nuk e kaluam kurrë normën mbi 103 për qind — u hodh prapë Toli.
— Ishte i rrezikshëm shumë. Me kandar farmacie ta peshonte, — sqaroi Coli më tej. — Ishte e pa mundur t'ia hidhje.
- Kështu bisedonin Toli, Loli dhe Coli, që të tre punëtorë, anëtarët më të padisiplinuar të një brigadë. Ata kishin hyrë në kafene dhe kishin vënë përpara gotat e rakisë së bashku me mezetë përkatëse. Fjalën e kishin për Dhimitrin, i cili kishte qenë normist në sektorin e tyre dhe tanë ishte transferuar në një sektor tjeter, po të asaj ndërmarrjeje. Ata ishin gjithë gëzim se kishin «shpëtuar» nga ky njeri.
- More shokëni, — e mori fjalën prapë Toli, — unë që në krye të herës e kam thënë dhe e them se normistët janë burokratë, ata e hanë bukën kot.

Tri ditë punë kanë, more shokëni, pastaj ditët e tjera, zinxhirin në dorë dhe vijnë vërdallë.

— E, po me ato tre ditë pune, o Toli, ai e nxjerr rrogën e tij, — tha Coli. — Dëgjo këtu, është tjetër punë se ne na e ka qejfi të shjmë lëmë po ama, të flasësh hakçe, normisti është kyçi i parasë tek ne.

— Shihe, shihe! Sa i zgjuar ky djalë, ore! —



tha Loli me tē tallur. — Sikur ti, Coli, ta kishe kokën nga ke këmbët do tē qe më mirë, sepse, kur tē piye ujë në burim, nuk do kishe nevojë tē ule-she fare. — Të tjerët ia dhanë gazit aq sa edhe ata që ishin ulur rrëth tyre u habitën.

— But, o çuna, but! — tha një klient që pinte kafe pranë tryezës së tyre. — Kujdes, se nuk jeni në fushë këtu!

— E more, shoko, mirë e ke ti, po, sikur ta dije ti se ç'gëzim kemi ne sot, do tē qeshje dhe do tē gë-joze edhe ti, — i ktheu përgjigje Loli.

— Gëzim paçi nga herë, o shok, po çdo gjë me anë e me udhë! — foli prapë klienti nga tryeza tjetër.

— Na fal, shok, na fal! — Kërkoi ndjesë Coli.

— Nuk bëjmë mirë që sillemi kështu.

— Në rregull, nuk bëjmë mirë. Ja, gëzuar! — ngriti gotën Toli dhe tē tre i takuan me njëra-tjet-rën.

Në trotuar, me duar prapa, qetë-qetë, kalonte usta Taka, një nga mjeshtërit më të vjetër, që para disa kohësh kishte dalë në pension.

— Usta Taka! — tha Loli.

— Ku?

— Ja!

Ata trokitën në xham dhe ustai ktheu kokën.

— Hajde bujrum, usta! — e ftoi Coli.

— Ju bëftë mirë djema! — i uroi usta Taka. —

Po, ç'është kështu?! Sot nuk është as ditë rrugash!

— Ulu, ulu, usta! Ktheje një gotë! — tha Coli.

— A, për një gotë nuk po ulem fare. Sa tē prish gojën kot së koti, më mirë hiç fare.

— Jo, mor usta, pi sa tē duash! — i thanë Loli me Tolin.

— Po, hair qoftë! Ç'është kjo?! — pyeti ustai.

- Ashtu, kot, — u përgjigj Loli.
— Kot?! Asgjë nuk bëhet kot, çdo gjë ka arsyen e vet, pra, edhe kjo e juaja. Po, duket se qenka fejuar Coli.
— Jo, usta, s'ka nuse fare, — u përgjigj Coli.
— E po ç'djall keni?! — pyeti si me të qeshur ustai.
— Epo gëzuar, usta!
— Gëzuar, çuna, gëzuar!
— Shyqyr që shpëtuat, thuaj usta! — tha Loli.
— Nga kush, more? — pyeti me habi plaku.
— Kemi patur një normist, xha Taka, Dhimitrin, ti e njeh! — foi Toli.
— Dhimitri! Djalë xhevahir!
— Ai xhevahir?! Ai as për llamarinë nuk bilihëj, o usta Taka, jo më për xhevahir, — u përgjigj edhe këtë herë Toli.
— Për Dhimitrin thoni kështu? Nuk ju kuptoj, o çuna.
— Jo, për Dhimitrin, — u tall Toli, — po për shokun Dhimitër, o xha Taka. Ja, gëzuar!
— Po Dhimitrin ku e shpunë?
— E transferuan në një sektor tjetër, — tha Coli.
— Ëhë! — u përgjigj i lehtësuar ustai që, nga sa dukej, e kishte për zemër Dhimitrin. — Po tek ju kush erdhi?
— Erdhi Urani, — u hodhën Toli dhe Loli njëherësh, — shoku Uran.
— Nuk e njoh, — tha ustai.
— Është i ri. Pak kohë ka që ka ardhur në ndërmarrjen tonë, — foli Coli ashtu i qetë siç e kishte zakon.
— Nuk e njoh. Po, ç'rëndësi ka? Ju paskeni

shpëtuar?! — pyeti ustai, po këtë herë pyetja e tij ishte ironike.

— Po, po, ne lindëm, usta, — u hodh Loli.

— E mëra vesh. Që të tre, ju si punëtorë nuk ua ha qeni shkopin.

— Pse, jo usta? — pyeti Loli.

— Thashë, pra, shokë paçi veten. Unë kam kujtuar se ju do të kishit ndryshuar, po, me sa shoh, prapë, paskeni mbetur te bishti i urës.

— Usta, na vjen keq! — foli Loli.

— Pse t'ju vijë keq?! Unë ju kam patur në brigadë. Tre orë një govatë llaç mezi ma gatuaje ti, shoku Loli.

— E po qemë të rinj atëherë, usta, — foli Loli.

— Po dhe tashti që po plakeni, mendt nuk i paskeni ndryshuar fare, xhanëm? Po, nejse, Dhimitri iku, ë?

— Iku.

— Erdhi Urani?

— Po.

— Paskeni shpëtuar vërtet. Ai qerrata Dhimitër ta peshonte punën me derhem farmacie.

— Tamam, usta, ashtu bënte, — u hodh Loli sikur ta kishte pickuar dikush nga prapa.

— Atij ishte vështirë t'ja hidhje.

— Më lehtë kaloje malin e Tomorit se sa listë pagesat te ai.

— Nuk të linte të shënoje: jo transporte, jo pas-trime me fshesë, jo larje xhamash, io...

Meazallah, usta, as dhjetë qindarka, ishte i tmerrshëm! — foli prapë Loli.

— Or, po interesant, xhanëm! — vazhdoi ustai shakanë e tij, të cilën ata akoma nuk po ia merrnin vesh. — Sikur i kishte lekët e të atit.

— Po, ose, e mori dreqi e mori, më keq se sa t'i kishte të tijat! — tha Toli. — Ke parë ti kështu?!

— Djalë i ri Dhimitri, — tha ustai përsëri, — po q'i duhej atij! Ai t'ju linte juve të merrnit sa të donit dhe!...

— Hiç gjë pastaj! Ai në punën e tij, ne në tonën, — u përgjigj Loli.

— Ashtu është! — tha ustai. — E po, e paskeni shtruar me të drejtë!

— Shyqyr që erdhe në fjalën tonë, o usta Taka — u hodh Loli.

— Po ky Urani, që paska ardhur i ri, si duket?

— S'e njohim, po shyqyr që na iku Dhimitri, thuaj! Ai ishte ç'ishte!

— Mirë, or çuna, mirë, dëgjoni plakun ju! Po s'ndërruat ju, normistët njëlloj janë...

«PADREJTÉSITÉ» E ARBITRIT

Unë, Kristaqi, djali i Thomait, së bashku me banë u nisa për në stadium një çerek ore para fillimit të ndeshjes. Zumë vend në tribunën qendrore. Si zakonisht, përshëndeta ata që kisha rrëth e rrotull, dhe shpejt e shpejt bëmë një farë parashikimi për ndeshjen: «dy me një në favorin tonë».

Dy skuadrat dolën në fushë për të bërë nxehjen. Tribuna dhe gjithë stadiumi u ngrit më këmbë dhe duartrokitjet ishin të zjarra. Babai hapi sytë dhe, nga që s'pati nga t'ja mbante, u ngrit edhe ai në këmbë.

— Ç'kanë kështu, more bir?! — më pyeti.

— Inkurajonë skuadrën, baba.

— Po mirë, more bir, inkurajoni skuadrën, po ç'kini që thërrisni si të tèrbuar?!

— Jemi tifoza, mor baba. E di ç'domethënë tifoz?

— Pse nuk thua më mirë se qënkeni karagjoza!

Oj, sikur u kafshoi zagari!

— Xhaxho, shtyu ca më tutje! — foli njëri që erdhi me vonesë dhe që kërkonte, ashtu në rrëmuje e sipër, të siguronte ndonjë copë vend.

— Nga të shkoj, more bir, nuk e sheh që është Kristaqi?

— Nuk paska qënë dhe i ati i Kristaqit?

— Po, i ati i Kristaqit jam unë.

— Ehu! Paske llafe, shtyu më tej të thonë!

— Të kesh turp, kur më thua mua plakut kësh-tu! Unë jam ulur në vendin tim. Ja tek e ke biletën, shikoje! — dhe i tregoi biletën. — Po s'ke faj ti, ka faj ky që më solli këtu... — dhe m'u drejtua mua.

Loja vazhdonte. Shansi tregonite se do të ishte me ne. Pastaj, or të lutem shumë, ne jo kot kishim parashikuar rezultatin dy me një në favorin tonë. Mirëpo punën na e «prishi» arbitri. Ai dha një derr faulli kundër nesh, fare kot.

— Qeros! — thërriti njëri që ishte ulur para nesh. Për dreq atë ditë arbitri, vërtet, kishte qëlluar pa flokë. — Të plaçin sytë! Nuk e pe?! Fajin e kishin të tjerët e jo tanët, o i shitur! Ta rregullojmë ne, kur të mbarojë loja.

— Kujt i thoni kështu? — më pyeti babai.

— Referit, — u përgjigja shpejt e shpejt, se nuk kisha kohë ta zgjasja më tej llafin me babanë.

— I gjori! — foli babai me keqardhje. — Të kisha qenë si ai do ta kisha flakur tutje atë qerrata bilbil.

Faulli u gjuajt dhe gol nuk pati. Tanët po sulmonin, bile shkuan edhe deri afër portës. I dhanë një top të bukur Arjanit dhe ai gati sa ta gjuante, ashtu, vetëm për vetëm me portierin kundërshtar po nuk e la arbitri. Ai prapë «e prishi» punën. «Posicion jashtë loje», — tha.

— Derr me zile! Idiot! Injorant! Edepsëz! Nuk e pe, more syplasur që mbrojtësi i kundërshtarit ishte përpara Arjanit?! Bile, Arjani e kaloi bukur! — filloj të shfrynte ai personi që, bëri si bëri, dhe zuri

një vend pranë nesh e që tërë kohës shfrynte i pakënaqur:

— Ç' flet ashtu, mor i uruar?! — u hodh njëri që qe ulur një radhë para nesh dhe që, gjatë ndeshjes rrinte qetë aq sa unë pata menduar: «Njerëz si ky kot që vijnë në stadium». — Arjani kishte depërtuar në zonë dy-tre metra para mbrojtësit kundërshtar.

Do të kishte plasur sherri, sikur ai që foli i dyti të mos kthente kurrizin dhe të vazhdonte të shihte ndeshjen. Unë, që më në fund takova një tifoz të vërtetë, shok me të cilin do të qanim hallet, fillova të ankoresha se kështu na e punonin ne arbitrat e të dy, me zjarr, filluam të numëronim «padrejtësitë» që arbitrat na kishin bërë që kur ishte krijuar futbolli në qytetin tonë.

— Ç'keni që ziheni, more të uruar?! Lëre ky po dhe ti!

— E po sporti kështu e ka, o baba...

— Jo, djale! Ke ardhur të shohësh lojën, rri urtë! Ke qejf të fitojë ajo skuadër që simpatizon? Bukuri! Po pse e shan të birin e botës?!

Po plaku nuk vazhdoi dot më tutje, se para portës kundërshtare u rrëzua një lojtar i yni, dhe stadiumi i tërë u çua më këmbë.

— Penallti, arbitro! Penallti, more mistrec!

Mirëpo, arbitri nuk na e vari fare.

Jo vetëm penallti nuk dha, po dha faull kundër nesh. Dhe prapë tifozët filluan avazin e vjetër.

«Maskara! O, i shitur!» Dhe çfarë nuk i thanë, po ai vazhdoi lojën. Nervat tonë kishin shkuar në stratosferë. Doemos, nga «padrejtësitë» e arbitrit.

Lojës po i vinte fundi. «Bereqaversën, thamë, të marrim një pikë se dy nuk na la arbitri t'i merr-

nim». Mirëpo, edhe këtu hesapet i kishim bërë gabim. Para portës sonë një lëmsh i ngatërruar të cilin e shkatërrroi një lojtar i skuadrës kundërshtare, duke e dërguar topin në rrjetën e portës sonë. Dhe atëherë, ishte e ç'ishte:

— Gol me dorë. Ja, më plaçin sytë! Ore, për kokën e kalamajve në ju gënjej! Po qe i téri me dorë, more vëlla. Mos gjetsha njeri të gjallë në shtëpi që qe me dorë! Po ai, i poshtri, arbitri na e bëri këtë. Do t'ia rregullojmë ne qejfin kur të mbarojë loja».

Dhe loja mbaroi me fitoren e kundërshtarit. E nuk mjaftoi kjo, po lojtarët e dy ekipeve u përqafuan me njëri-tjetrin si të ishin fis, bile guxuan t'i jepnin dorën edhe arbitrit.

«Ore vëlla! Pse e zgjat më tutje, si lojtarët dhe arbitri janë maskarenj. Po, i jepet dora këtij arbitri?! Po përqafohen këta lojtarë që të kanë rrasur një gol, dhe bile me dorë?! Ata duhen ngrënë me dhëmbë, more shokë, me dhëmbë!»

Duke thirrur si të çmendur, domosdo nga «paderjtësitë» e arbitrit, dolëm te sheshi prapa tribunës qendrore. Kërkuam arbitrin për t'i mbajtur premtimin që i dhamë. Po arbitrin nuk e gjetëm. Babai m'u betua se nuk do të vinte më në fushë. Mirëpo tani nuk shkoj më as unë, se publikun tonë e dënuan.

NË SHTËPI MYSAFIR, NË LAGJE RADIO PAZARI

Kthehesha nga një shërbim dhe ndjehesha i lo-dhur. Mora rrugën për në shtëpi. Me qenë se nuk kisha çelës me vete, gjatë tërë rrugës mendova se ç'do të bëja po të mos kisha dritë, domethënë njeri në shtëpi. «Do të hyj në ndonjë kafene» — mendova. Dhe vërtet, me qenë se nuk gjeta njeri në shtëpi, u futa të pi ja kafe në një nga lokalet e qytetit tonë. Në fund të sallës ishin ulur një grup njerëzish, midis tyre ishte dhe një shoku im. Ai ngriti dorën dhe më ftoi. Megjithëse ishin shumë, shkova dhe unë. Ata vazhdonin bisedën dhe qeshnin.

— Mbrëmë, — vazhdoi bisedën e lënë përgjysmë Bimi, — unë arrita të pi deri në 20 shishe burrë, domethënë një arkë komplet.

— Ua! Ç'rekord lokal! — tha një tjetër.

— Pse lokal dhe jo kombëtar?!

— Bile ndërkombëtar, — thashë unë me shpoti.

— Në fund të fundit rekord është, — tha Bimi dhe qeshën të gjithë.

— E dini ç'më gjeti mua, — tha Latifi, — këtu e dy-tre vjet të shkuara, sa kisha mbaruar shkollën e mesme? Po udhëtoja ulur në autobus urban. Në një stacion hipit një burrë i vjetër, i veshur mirë me

borsalinë në kokë, dhe shtynte me sa fuqi që kishte.

— Avash, ore shok, — i fola.

— Më fal, — tha ai, — ngushticë është!

— Ngushticë pa ngushticë, mos m'u var ashtu!
Apo, mos do të ngrihem unë e të ulesh ti? — i thashë.

— E mira dhe rregulli ashtu e do, — m'u përgjigj.

— Ka thënë drejt, — i thashë Latifit, — vendi i lirohet gjithmonë një më të moskuari.

— Mirépo, më quajti «njeri pa kulturë».

— Cudi! — tha Bimi. — Ty të quajti pa kulturë, ty që ke një kalë shkollë!

— Hë de, ke parë kështu ti?!

— Ore çuna, në ç'orë mbyll furri i bukës? — pyeti Trifoni.

— Pse? — tha Latifi.

— Sepse mbrëmë harrova që gruaja më kishte porositur të merrja bukë dhe, kur shkova në shtëpi, plasi sherri.

— Mirë që të qenka bërë mësim, — i thashë.

— Ishallah harroj edhe sonte! — tha Trifoni.

— Nesër kemi ndeshje futbolli, — tha Bimi.

— Mos ma kujto, — u përgjegj Mersini, — se njëherë desh kam vajtur në burg kot së koti!... Këtu e dymbëdhjetë vjet të shkuara, — vazhdoi Mersini, — luhej futboll te fusha e vjetër. Loja kishte dy minuta që kishte mbaruar, kur arbitri na dha penallti. Atëherë unë nuk u mbajta më. U futa në fushë dhe kush e di ç'do të kisha bërë, sikur të mos më kishte kapur polici. Tashti ulem larg që, edhe sikur të ndodhë gjë, të mos kem mundësi të futem në fushë. — e përfundoi llafin ai.

— Kemi tre orë këtu brenda, — tha Latifi. —

Hajde dalim jashtë e bëjmë nja dy xhiro se plasëm!

Dhe dolëm. Shokët, me të cilët më shoqëroi shoku im, së pari, morën në analizë veshjen e çdo njërit që panë në rrugë, origjinën shoqërore dhe funksionin që kryejnë. Pastaj, akuzuan ata burra që kishin dalë shëtitje me gratë.

— More, dy këmbët në një këpucë ua kanë vënë gratë disave! — tha Latifi.

— Zall, fare ua kanë bërë! — tha Bimi.

— E po, ta hajë dreqi, një burrë të tillë që mbetet prapa fustanit të gruas, — tha Mersini.

Së treti, u morën të dhëna mbi fytyrat e reja që kishin ardhur në qytetin tonë, qofshin këto femra, apo meshkuj. U kërkua, më vonë, misioni i ardhjes së tyre: janë tranzit, mysafirë, vizitorë apo shkojnë në kampin e Divjakës?

Mbasi u zgjidh edhe ky problem me kaq «rëndësi», vazhduam të matnim me hap të rregullt pllakat e granilit me të cilat është shtruar trotuari i bulevardit. Na kishte pllakosur heshtja dhe secili ecte në punën e vet. Unë vazhdoja të shikoja nga apartamenti im se mos po ndizeshin dritat. Po, akoma jo. Duket, gruaja do të kishte vajtur tek ndonjë shoqe e saj. Fundja, kishte të drejtë, po unë pse e lashë çelësin e shtëpisë te pantallonat e tjera? Mirë të më bëhet!

— Au! Po kjo përsë mbaroi?

Kthyen kokën të gjithë. Trifoni e kishte fjalën për Dritën, një vajzë e mirë në qytetin tonë, këtë e mëra vesh më vonë.

— Për mjeke, — i dha përgjigje Mersini.

— More, more, e kam patur në klasë, në gjimnaz, tapë ka qënë fare. Shiko dhe si mbahet, pa le, kujton se nuk e njobhim ne!

— E ke gabim, — fola unë. — Kjo, jo vetëm që është vajzë e mirë, por dhe në mësimë është dalluar. — Nuk vazhdova dot më tej sepse Mersini u hodh me të shpejtë në bisedë.

— Uu! Bakiu qenka fejuar! Bukur fort! Po me cilën se?

— Me Marikën, — tha Bimi.

— Jo ore, të bijën e xha Stefanit paska marrë. Të them të drejtën xha Stefani është burrë zotni, po kjo Marika se nga ka ngjarë, pipirickë djegëse është fare.

— E, mirë, se mos Bakiu është dritë në diell, nuk e sheh?! — tha Mersini.

— Shikoni atje tej, more shokëni! — tha Trifoni. Ata kthyen kokën.

— Simoni më Zelihanë?! — shfaqi habinë Bimi. — Për ta u fol sikur u ndanë!

— Ndaj u habita edhe unë! — foli Trifoni.

— Ua, thua të jenë bashkuar përsëri! — tha Latifi. — Se që u ndanë kjo është e sigurt. Mua ma tha Seiti. Kishte qenë në sallën e gjyqit.

— Dëshmitar? — pyeti Mersini.

— Jo, mor vëlla, dëshmitar, dëgjues. Ç'i duhej atij dëshmitarllëku! — u hodh Latifi në mbrojtje.

— Me sa di, — fola unë që më kishte ardhur qumështi në majë të hundës, — shoqja Zeliha është ndihmësgjyqtare. E mos i keni ngatërruar.

— Po Simoni ç'deshi? — më preu llafin Trifoni.

— Kushedi, ç'punë ka pasur. Ndoshta, për të marrë çelësin e shtëpisë. Çelësi më futi dhe mua në shoqërinë tuaj kaq të lartë.

Ata heshtën. Unë pashë nga apartamenti im. Dritat qenë ndezur.

— Mua tani të më falni, — u thashë, — se do të iki!

— Pse? — pyeti Bimi. Ne tashti sa e ngrehëm muhabetin, ti do të na e prishësh.

— Ju vazhdojeni, — u thashë, — se ia vlen të merreni me të tilla gjëra! Ndërsa unë mjaft shëtita. Tani do të shkoj të rri në shtëpi të bisedoj me gruan.

— I lumi ti! — tha Mersini — që ke kohë. Ne s'kemi kohë fare. E di kujt i thonë fare, asnje minutë.

— Na morën shpirtin mbledhjet, more shokëni, — tha Bimi.

— Besomëni, më kanë thënë, se në qytetin tonë ka dy muzeume. Kam disa ditë që e kam marrë vesh e megjithatë jo vetëm që nuk i kam parë e vizituar, po as ndërtesat nuk ua di — tha Trifoni.

— Shkoni sonte! — u thashë unë. — Keni kohë, larg nuk janë, edhe kohën e kaloni më mirë, edhe diçka mësoni.

— Mirë e ka shoku, — tha Mersini, — po në nuk merremi me këto gjëra.

— Me se merreni ju? — i pyeta.

— Po ja, me punë.

— Me ç'punë, more të uruar?! S'latë njeri pa marrë nëpër gojë! — Unë duke iu drejtuar shokut tim, që më kishte ftuar në tryezë shtova:

— C'e humbisni kohën kot, or të uruar, duke u sorollatur poshtë e përpjetë pa punë e pa bereqet?!

E ndieva që s'u erdhi mirë nga fjalët që u thashë, por unë u zgjata dorën të ndahesha:

— Natën e mirë, Trifon! Dhe se mos harrosh përsëri të blesh bukë!

— U, vërtet, mirë që më kujtove. Ja tani do të ikim dhe ne.

— Ikim? tha Mersini.

— Ikim! tha dhe Bimi.

MOS NA NGATERRO ME PUNĘTORĘT!

— Vendi që mbanit deri tani ju, shoku Veli, — më njoftoi shefi i kuadrit, — në bazë të propozimit të punętorëve shkurtohet. Ju s'ishit në mbledhjen e fundit...

— Jo, qeshë me shërbim, — u hodha shpejt, sepse e dija që shefi i ka qejf këto «zbulime».

— E di, e di, — tha, — po atje kolektivi doli me një propozim. Kështu që, për të çuar në vend fjalën e punętorëve, — tani shoku Haki filloi të flasë me seriozitetin e tij të zakontë prej shefi, — ne menduam t'ju lëvizim. Ju do të shkoni me të njëjtën detyrë, në kantierin e parë.

— Në kantierin e parë?

— E po në të parin, de, e jo në të dytin!

— Dakord! — thashë dhe dola jashtë. Ç'ta zgajasja më tej, kur urdhri ishte i formës së prerë.

Rrija në zyrë dhe, me qenë se kolegu im mungonte, zhvillova më vete këtë bisedë:

«— Në qoftë se do të nevojitej në kantierin e parë puna ime atëherë kjo gjë do të qe zgjidhur dhe aprovuar me kohë.

— Çfarë nevoje, morz i uruar! Shko, mor atje e bëj qejf se s'ka punë fare! More vesh?!

— Nuk jam njeri i qejfit unë jo. Dua punë. E dini kujt i thonë punë?

— E dimë, por një gjë nuk e kuption ti. Me largimin tënd prej këtej ne përfitojmë një kuadër tjetër.

— Në ç'mënyrë vallë?

— Kollaj fare. Ti do të shkosh në kantierin e parë?

— Po, — pohova unë.

— Ekstra fare! Punën tënde këtu do ta bëjë shoku Tafil. Mirëpo, ai nuk mund të përballojë dot dy detyra. Atëherë, u thuhet shokëve punëtorë: «E more shokë, ja dhe propozimi juaj nuk doli gjë!» dhe ti vjen në vendin e mëparshëm, ndërsa në kantierin e parë çojmë një tjetër, se, domosdo, shkohet përpara jo prapa... E kuption?

— E kuptojoj. Veç një gjë nuk e kam të qartë.

— Çfarë?

— Punëtorët kërkuan që të shkurtohej vendi që mbaj pikërisht unë, apo thanë të shihej se mos kish te njerëz të tepërt në administratë?

— Pooo...

— S'ka po, e jo. Si folën?

Shefi i kuadrit diç përtypi, veçse unë një gjë e kuptova, që nuk më tha të vërtetë, ndaj dhe vazhdova:

— Përse atëherë, nuk shkurtuat në degën ku është shoku Sifi kryetar, që janë pesë vetë, apo në sektorin e llogarisë... Dhe unë fillova t'i numëroja me radhë sektorët, ku njerëzit janë shtuar aq shumë, sa është rrezik të hanë njëri-tjetrin.

— Po ja, more Veli, vëllai, disa nga ata janë të sëmurë, të tjerët gati për t'u sëmurë, një pjesë nuk para e kanë qejf largimin nga zyra dhe...

— Dhe çfarë? Apo i shikoni problemet ekonomike me gjyslykë të zeza?

— Të lutem!

— Aspak, mos m'u lut! Ju kujtoni se punën time mund ta bëjë shoku Tafil? Nuk është e vërtetë.

— E thamë që në fillim punën e shokut Tafil...

— Atëherë ju, shokë, talleni me propozimet e punëtorëve...

— Më falni, po më duket se po e teproni!

— Aspak! Në sektorin ku punoj unë, shokët punëtorë... Unë i di propozimet e tyre, edhe juve...

— I di.

— Kur i di, përse atëherë?...

— Epo ta thashë arsyen. Pastaj, ky është vendim,

— Vetëm më duket i nxituar, dhe në dëm të punës.

— Ky është urdhër, — tha ai.

— Këtë urdhër do ta shtrojmë në mes të punëtorëve. Në qoftë se ata do ta aprovojnë, dakord!

— Mos na ngatërrro me punëtorët!»

Ky dialog midis meje dhe shokut Haki kush e di sa do kishte zgjatur, sikur në zyrën time të mos hynte shoku Behar, kryetari i komitetit profesional të ndërmarrjes. Ai, siç duket, më pa të shëmtuar e të ngrysur në fytyrë e më pyeti:

— Ç'ke Veli?

Unë ia shpjegova shokut Behar çfarë më kishte komunikuar shefi i kuadrit.

— Mirë, — tha shoku Behar — do mbledhim punëtorët dhe do t'u themi kështu si të ka thënë shoku Haki.

— Dakord! — i thashë unë. — Po shoku Haki nuk do.



— Hakiu mbase nuk do, po duan punëtorët që t'u vejë shoku Haki.

Dhe iku shoku Behar.

Mbas ca ditësh në zyrën time erdhi shoku Haki dhe shkurt më komunikoi.

— Urdhri për të shkuar ju, Veli, në sektorin e parë anullohet. Vazhdoni punën! Ditën e mirë!

— Një minutë, shoku Haki!

— Urdhéro!

— Atij djalit të mikut, që e more tornitor, dhe atij djalit të shitésit të qumështit gjejuni vend, mba-si janë të tepërt në oficinë! Këtë e dinit.

— E di, e di, po ku t'i çoj?

— Ku të doni, vetëm në oficinë jo, se ka mbi-fuqi punëtore, më kupton?

— Unë të kuptoj po nuk kam ku t'i çoj, hë për hë.

— Shoku Haki, ose ata do të largohen, ose unë do ta bëj problem të punëtorëve!

— Veli, për kokën tënde, mos na ngatërrro më me punëtorët se më kanë bërë për t'u fërkuar me vaj e me uthull! — Dhe iku shoku Haki.

MUA TË MË RROJË PËRGJEGJËSI ...

Kishte plot dhjetë ditë që përgjegjësi im i dashur, shoku Veli, (ndonëse s'kishte veçse një muaj që qe fejuar), rrinte i mërzitur sikur t'i kishte shkelur gomari në presh.

Bre, pse i qeshë lutur e falur të më tregonte arsyen e kësaj mërzie, prapëseprapë nuk më tha asnje gjysmë fjale.

Dhe dita shtynte ditën. Dhe përgjegjësi im nga dita në ditë e më i mërzitur. Pas tij fillova të mërzitem edhe unë, bile më këq se ai. Se fundja, kur përgjegjësi e ka hallin një fish, ti, si vartës, duhet ta kesh të paktën dy fish. Apo jo? Mirëpo më gjeti nalli me gruan.

— Vasil, ç'ke kështu? Ç'është kjo mërzi e mëdha që të ka zënë? — më thoshte ajo.

— E, moj Shpresë, ashtu është vërtet. Po ne kemi një hall.

— Cfarë halli?

— Kam përgjegjësin të mërzitur.

— Pse?

— Nuk ma thotë. Plasa. Nuk flet..

— Epo kushedi ç'hall ka?

— Të lutem, shoqja Shpresë, mos u bëj indiferente!

Dhe gati për ditë grindesha me gruan, sepse, të them të drejtën, më nervozonte indiferentizmi i saj.

Kështu hyri në shtëpinë tonë grindja. I varfëri unë! O përgjegjës të hengërt fruthi me gjithë mërzitjen tënde! Mirëpo, çështë e vërteta, kur thashë këto fjalët e fundit, hodha sytë nga dritarja për të parë se mos më kishte dëgjuar njeri dhe ia thoshte përgjegjësit.

... Një ditë dola nga shtëpia, për në punë, si zakonisht. Zura pozicionin e zakonshëm për t'i thënë përgjegjësit «Mirëmëngjesin» e përditshëm. Po ai nuk po dukej. Dhe të nesërmien po kështu. Prita. S'ka! Vajti ora tetë. Prapë përgjegjësi s'po dukej! Dermani për përgjegjësin! Pyeta shokët se mos dinin gjë, po hiç gjë. Halli! Po s'mjaftoi kjo dhe m'u mblodhën nja dhjetë punëtorë.

— More brigadjer! — filluan të flasin të nervozuar.

— Ç'keni, more që thërrisni?

— Kemi mbetur pa front pune. Vajti ora tetë.

— Keni mbetur pa punë? — pyeta unë. — Më shtruar, se më duket se po mbetemi pa përgjegjës, pa puna e punës suaj rregullohet kollaj.

— Pse ç'e gjeti përgjegjësin? — pyeti Selimi, një nga të dhjetë.

— E ku ta di unë, ka dy ditë që s'vjen fare në punë!

— Mos u bëj merak se s'e gjen gjë, po na gjej front pune!

— Këputni qafën! — u thashë, se më erdhë inat. S'kanë pikë respekti, xhanëm, për përgjegjësin! — Shkon bëni qymyr! — Kaq isha inatosur, sa, në

vend që të thoshja, «Shkoni bëni kanal!», thashë «shkoni bëni qymyr!», po shpejt e ndreqa: — Shkoni bëni kanal aty, prapa sektorit!

Ata shkuan në kanal, kurse unë e mbajta frymën në pazar. Piva një kafe. Nga halli edhe një férnet. Që aty, drejt e te shtëpia e përgjegjësit. Mbajta vesh, kur u afrova pranë shtëpisë, po nuk dëgjova asnje zhurmë. Në shtëpi nuk kishte njeri. «Dreqi e hëngërt!» — fola nën zë, dhe vazhdova kërkimin. Nuk e di, po në një moment mendja më vajti te «Lunja e Karbunarës». Mendova se njeriu nga e keqja bën edhe të pa bërën. «Kushedi ç'hall ka patur?!» dhe në moment përfytyrova përgjegjësin tim, shokun Veli, me një gur të varur në qafë, duke u hedhur nga ura poshtë. Të them të drejtën u trondita aq shumë, sa e humba dhe, pa vetëdije, mora rrugën për te «Lunja». Rrugës dhe para degës ushtarakë kishte plot njerëz. Të rintjtë shkonin ushtarë. Kur ja, midis tyre më zuri syri edhe përgjegjësin tim, i cili mbante në dorë një trastë të mbushur plot. Doe mos me ushqime.

— Ah! — thashë. — E pat dhe përgjegjësi, e muarën ushtar! Po ky ç'ka mibetur gjer tashti rekrut?! Nuk është dhe fort i ri. Paska patur hak i ziu që s'na e tregonte hallin. I vinte turp, të shkrëtit. U afrova. I dhashë dorën. Sytë mu mbushën me lot, po e mbajta veten, nuk qava.

— Të vesh e të vish shëndoshë! — i thashë.

— Të faleminderit! — m'u përgjigj.

Më marifet u shkëputa për disa minuta dhe hyra në bufenë që ishte aty pranë. I bleva nja katër paga «Ardian», dy pakò biskota dhe, pa humbur kohë, u gjenda pranë tij dhe ia dhashë.

— Merri përgjegjës! Dhe mië fal se nuk pata mundësi më tepër.

— Ç'i deshe këto? — tha ai. — Epo, faleminderit e t'i paça borxh!

«T'i paça borxh?» Unë ushtrinë e kam bërë, o përgjegjës!»

— Mua mië fal, — i thashë, — se do të iki, — dhe i zgjata dorën. — Të vesh e të vish shëndoshë dhe mos u mërzit!

Dhe ika. Ika, po më erdhi keq. Përgjegjës, jo shaka. Rrugës mendoja: «Kush e di cili do të nă vijë përgjegjës. Ky i shkreti qe i mirë: as llogari të kërkonte, as të therriste dhe as të bërtiste».

Me këto mendime arrita në sektor. Në qendrën ku vendosen fletërrufetë ishin grumbulluar njerëz. Bëhej pushimi i drekës. U afrova dhe unë, po ç'të shikoj? Një fletërrufe sa një çarçaf dopio ishte vendosur në adresë të përgjegjësit tim, shokut Veli.

«Që nga data 20 nëntor, kur vëllai i të fejuarës suaj u njoftua se në fund të muajit do të nisej ushtar, e deri më sot, ju, shoku Veli, ja keni varur punës fare. Madje, këto dy ditët e fundit as nuk jeni dukur fare në ndërmarrje. Ku punohet kështu?! Orari zyrtar është ligj. Me ç'të drejtë e shkelni ju atë?! Presim përgjigje!

Punëtorët e sektorit III.»

— More shokë, — u thashë, — e keni gabim. Përgjegjësi nuk po përcillte të vëllanë e të fejuarës, por po shkonte vetë ushtar.

Ata qeshën.

— Pse qeshni?

— Se nuk qajmë dot për ato mendt e tua të bukura!

— Domethënë, nuk shkon vetë shoku Veli ushtar?! Epo mua të më rrojë përgjegjësi pa... (po këto i thashë nën zë, sepse pashë që punëtorët ishin shumë të revoltuar).

Ç'KAM PARË SOT, MOS PAFSHA MË, AS NESËR DHE, AS KURRË!

Këtë javë isha në turnin e dytë. Kisha fjetur bukuri, dhe, mbasi përçolla gruan për në punë, aty nga ora shtatë e dhjetë minuta, dola në dritaren e apartamentit tim dhe soditja qytetin.

Thashë që ora kishte shkuar shtatë e kusur dhe, domosdo, puna në zyrë kishte filluar. Kuptohet vetvetiu se ashtu duhej, ora xërr kalemi vërr.

Po më mirë do të kisha bërë të mos kisha dalë në dritare, se pashë ato që nuk dua t'i shoh as nesër dhe as kurrë ndonjëherë! Se e vërteta është që ne punëtorët nuk durojmë pluhura në veshë. Dhe ja po jua numëroj ato që pashë me këta dy sy:

Një infermiere e poliklinikës, tërë hundë e buzë (me sa dukej që ngritur mahmur, kur thonë), hidhje këmbët me aq përtesë mbi trotuar, sa të nervozonte. Ma mierr mendja se, sikur dikush ta pyeste:

«— Shoqe pacientët dhe mjeku në poliklinikë nuk po ju presin ju që shkoni kaq shtruar?!

— E mo, po fundja sot ata e kanë planifikuar ta kalojnë ditën në klinikë. E sa për mjekun, ai duhet të jetë në mbledhjen e mëngjesit.»

Kjo do të ishte përgjigja e saj me siguri, për derisa nuk e bënte qejfin qeder, kur thonë.

«S'ke faj, moj shoqe, — thashë me vete, — shtruar merre! Pse jo, kur të lënë, shi edhe lëm!»

Po të kishte qenë i vetëm ky rast, unë nuk do të isha shqetësuar aq shumë se, fundja, njerëz jemi, kemi edhe halle, madje aq më tepër një grua. Po kjo kishte qenë ditë ters, se Leni, llogaritarja e ndërmarrjes sonë, ia kishte marrë vrapi aq shpejt, sa që, me siguri, po ta shikonte ndonjë trainer i atletikës, do ta regjistronte ndoshta edhe për rekord kombëtar. E kisha larg Lenin se do t'i thoshja:


«E moj shoqja Leni, pse vrapon kot së koti?! Kur vajti mijë le të vejë edhe qindi! Merre shtruar edhe ti si infermierja! Pse jo?!»

Ora vazhdonte punën e saj, se e di e shkreta që atë punë ka për të bërë.

«Nejse, shkoi edhe kjo me të tjerat!...» — thashë me vete dhe mora të lexoja romanin «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo». Në ballkon binte dielli dhe unë po kënaqesha, kur zhurma e fortë e një borie «Gazi-69» më hodhi përpjetë.

Ishte gazi i një drejtori që rri në pallatin pranë nesh.

Pashë shokun Hasan që iu afrua gazit tërë nerva dhe diçka i foli shoferit. «E, mirë ia bëri! — po mendoja me vete. Ku ka parë ky shofer të shkojë me vonesë në shtëpinë e drejtorit?! Fundi, ai bëri që drejtori të shkojë vonë sot në punë... E kush e ka fajin de, thuaj! Shoferi, patjetër... Sos që vonohet për vete, po vonon dhe të tjerët. Për të le të merrën masa! More, deri në shkarkimin si shofer! Jo, po mund të guxojë ndonjëri dhe të thotë se drejtori duhet të shkojë më këmbë në zyrë! Po kjo me-



ndje është?! Si ore, drejtori, të shkojë më këmbë?! Ku është parë e dëgjuar kjo?! Është parë? E, drejtor Thimi, drejtor Nasi, drejtor...? Mirë de, mirë! Ata vërtet shkojnë më këmbë, po, kur ke mundësi, pse të mos e shfrytëzosh?! Ç'ke me ta! Pse s'permende Lamen ti që, kur iu prish gazi i tij, mori me qera, me paratë e shtetit, një taksi. E more, vëlla, e mori, çuditesh ti! Hiç, or, mos u çudit, janë gjëra që ngjasin! Po ama, kanë edhe hak... Kur disa nga ne qëndrojnë indiferentë dhe i lënë të livadhisin, ju lumtë edhe atyre!»

Drejtori u largua për në punë. Unë po qëndroja akoma, tërë nerva nga ato që pashë. Po ç'duhet të bëja? Të qëndroja edhe unë indiferent si disa? Jo! Asnjëherë jo! Dhe vendosa të shkruaja një fletërrufe. Dhe shkrova. Po fletërrufenë e shkrova edhe për ata punonjës që, kur shokët e tyre bëjnë gjimnastikën e mëngjesit, rrinë prapa perdeve të kafeneve, edhe për ata e për ato që u thonë shitësve «Të lutem pak shpejt se jam në orarin e punës!», edhe për ata që heshtin kur vënë re shkelje të orarit zyrtar.

Kthyen përgjigje? Bënë autokritikë? Bënë kthesë? Të shohim! Unë prapë jam në turnin e dytë.

PSE E ZURI GRIPI SHEFIN

Shoku Nader, shefi i im direkt, e kishte zyrën në katin e dytë. Në korridor qëndronte e mbështetur mirë pranë murit një portmanto (ose më saktë një mbajtëse palltosh,) në të cilën, sipas temperaturës, shoku Nader vendoste herë pardesynë, herë pallton së bashku me një shall të bukur të mëndafshët. Më sipër vinte kapelen e tij me strehë.

Këto sende personale, zinin vend aty që nga ora shtatë pa një çerek dhe largoheshin në orën dy e një çerek, doemos, për tu kthyer sërisht të hënave dhe të martave mbasdite. Gjatë ditës, ato largoheshin për të pirë një kafe apo diçka të tillë dhe mëbas një ore, ose e shumta një orë e gjysmë, ktheheshin përsëri në vendin e mëparshëm. Kjo lëvizje, bëhej qameti deri pesë herë në ditë, duke përfshirë edherastet e ditës së hënë e të martë mbasdite. Kjo gjë ra në sy të punonjësve, të cilët s'mënuan t'ia vënë në dukje shefit. Dhe shefi bëri kthesë. Pajimet personale të shokut shef ishin gjithmonë në portmanto, edhe kur ai s'gjendej në zyrë.

Një ditë, në mëngjes (sigurisht mbasi kishte filluar puna), unë shkova në zyrën e shokut Nader për

të sqaruar diçka. Të them të drejtën, nuk më kujtohet mirë se çfarë, po më duket se qe fjala për një reklamim ndeshjeje futbolli, që duhej të bënte klubbi ynë. Kur iu afrova zyrës së shefit, dëgjova që nga brënda një të kollitur të fortë.

«Paska njerëz brënda!» — thashë me vete dhe u largova më mendje që të vija më vonë. Mirëpo, puna nxjerr punë dhe unë harrova dhe u kujtova vetëm të nesërmen. Po, përsëri e kollitura nuk ishte larguar nga zyra, bile kishte zënë pozita më dominuese! «Thua të ketë njeri?» Nejse, e vendosa të hyj dhe trokita.

— Kush kollitej aq fort, shoku Nader? — e pyeta shefin tim direkt.

— Unë, — tha ai.

— Ju?! Duket, jeni ftohur?!

— S'e di as vetë, po ama kjo kollë po ma merr shpirtin.

— Duhet treguar kujdes! — i thashë. — Fundja, vizitohuni, merrni raport dhe mjekohuni!

— Po puna! Puna, mor djalë, puna!!

— Puna! Ç'duhet puna para shëndetit??

Pastaj ne vazhduam të diskutonim problemin për të cilin kisha shkuar. Si mbaruam, unë u largova. Kur shkova në zyrë, i tregova Rizait, kolegut tim, se shefin e kemi jo miirë me shëndet.

Të nesërmen, shefin e takova tek shkallët e ndërmarrjes. Një teshtimë e fortë nuk e la të më kthente pëershëndetjen e mëngjesit. «Çudi, thashë me vete, ku të ftohet ky? Zyra e tij jo vetëm që është e vogël dhe me kalorifer, por ai mban ndezur edhe reflektorin?»

Nejse, me këto mendime vajta në zyrë dhe nisa të punoj. Aty nga ora nëntë, mora një telegram ku



njoftohesha për një vdekje. Menjëherë shkova në zyrën e shefit për të marr leje. Ajo ishte e hapur po shefi s'qe aty. E kërkova tek zyrat pranë, po dhe atje s'qe. U ktheva dhe një herë në zyrë të shihja nëse ishte palltoja dhe pajimet e tjera të shefit. Ato qenë në vend. «Epo, këtu brenda do të jetë!» Mendova ta kërkoj tek drejtori dhe nëndrejtori. Ndërsa i pari më tha se s'kishte qenë fare në zyrë të tij, ‘dyti e kishte derën të mbyllur. Më polli belaja! Si t'ia bëja?! Koha s'prioste. Atëherë mendova t'i lija telegramin Rizait dhe vetë u nisa.

Dola në rrugë, kur shoh shefin tim, shokun Nader, të dalë prej kafenesë që kemi pranë, ashtu, fill në kostum.

— Po ti? — s'arriti ta mbarojë fjalën shefi, se një breshëri teshtimash shpërthyen.

Ia tregova hallin dhe i përsërita kërkesën për leje (ndonëse unë isha nisur pa leje).

— Po... Apshiu... mirë... apshiu.

U ndamë. Rrugës ndjehesha i qetë, se, së fundi, zbulova pse e kishte zënë gripi shefin tim.

NUK PRISHET DASMA PËR NJË «LIMON»

Një copë të mirë rruge (nja dy orë plot) e bëra me këmbë. Ishte korrik. E shtunë. Temperatura në dhomë arrinte 30°C . Djersët më shkonin çurk. Asnjë gjethë nuk lëvizte. Më kishin ftuar në dasmë. Një shoku im martonte djalin.

Te porta e shtëpisë, në një hije mani, qe ndërtuar një tendë e madhe që krijonte një hije për qejf. Në derën e tendës qëndronin si roje gjashtë djem, njëri më i shëndetshëm se tjetri. Secili prej tyre mbante në dorë një vegël muzikore. Sa më panë, ungritën dhe ia morën një melodie për shtatë palë qejfe. Mua më pikonin aq shumë djersë dhe ndjehesha aq shumë i lodhur, sa jo melodia e tyre, po dhe kënneta e Karavastasë nuk më freskonte dot. E, me gjithatë, zakoni është zakon. Halili, bashkë me të afërmit e tjerë më priten tërë gaz dhe më futën brenda në tendë. Shpejt e shpejt më sollën ujë të ftohtë nga pusi, kafe e gjithë të mirat. Mbasi e mora vreten pak u drejtova nga gjashtë djemtë.

— Po ju, o çuna, si jeni?

— Ç'ka, — m'u përgjigj ai me klarinetë. — Jo dhe keq.

— T'jua ketë hua i zoti i dasmës, o çuna! — u thashë.

— Ashtu qoftë! — tha një djalë tjetër që mban- te në squetull një def të vogël.

Miqtë filluan të vijnë, dhe njerëzit e shtëpisë filluan nga nderet dhe t'u caktonin vendet.

Nga qoshja ime, i pari vinte një burrë jo fort i vjetër dhe i veshur allafrenë, që i thoshin krushku Stefan; pastaj vija unë dhe pas meje vinte një kooperativist i veshur me një kostum karakteristik të krahinës, po muhabetçi dhe përparimtar.

Dhe plasi rakia. Dhe varda mezeja. Dhe forca dhëmbët për të blojtur. Qejfi po arrinte dalngadalë kulmin: Halili, si i zoti i dasmës dhe ati i dhëndrrit, bënte ç'bënte dhe i ngjiste në ballë fizarmonicistit (duket ai qe i pari i sazexhinjve) herë ndonjë 10-lekëshe, herë ndonjë 25-lekëshe dhe, jo rrallë, edhe ndonjë 50-lekëshe. Kishte dhe dasmorë të tjerë që e bënин këtë adet, po ata i përkisnin qoshes matanë. Ne këtej qëndronim akoma në pozita të forta.

— E, ju, qoshja andej, nuk e morët një herë këngë! — foli fizarmonicisti.

— Për të kënduar nuk dimë, o usta, tu bëfsha! — tha krushku Stefan. — Po zotrotë, gjeje një si përveten tënde!

— Peqe! — u përgjigjën sazexhijtë dhe ia morën melodisë «*Prapa malit me një fushë mushtulluk po vjen behari*».

— Nuk dinë t'i bien, — më foli me ngadalë kooperativisti. — Mblidhen ca çuna si Sokrati dhe të gjerrin veshët.

— Jo, — e kundërshtova unë, — goxha i bien!

— Eh, çfarë goxha, or mik?! Ku ma ke Shefito

Arixhinë me shokë! Ata po, e ngrinin të vdekurin nga varri!

Ndërkokë, krushku Stefan e futi dorën e majtë në xhep dhe nxorri portofolin. Sokrat sazexhiu e ngriti klarinetën lart, kurse sazexhijtë e tjerë lëvizën nga vendi. Ai që i binte defit, na u afrua dhe vuri kokën në prehrin e krushkut Stefan. Ky ia ngjeshi në ballë një 50-lekëshe. Pastaj sazexhiu i erdhi tek unë.

— Me kusht, — i thashë, — që t'i ndajmë bashkë.

— Hidh, or, paratë! — tha Peçi, kështu e quanin atë që i binte defit, — hidh, paratë, se u turpërova kot para këtij mileti!

— Tjetër turp mos paça! — i thashë, dhe ia ngrita kokën nga prehri. Ai më pa shtrembër e me inat dhe shkoi tek komshiu im.

— Vazhdo më tutje! — i tha kooperativisti. Peçi, me def në dorë, shkoi më tutje, po dhe ky i tha:

— Vazhdo më tutje.

E kështu, shty e shty, Peçi u gjend ballë për băllë fizarmonicistit. Sazexhijtë pushuan. Kjo e bëri nevrik dajkon, prandaj u ngrit në këmbë dhe tha:

— Të gjej, o krushku Stefan, me dhjetë gota raki, me shumë dashuri dhe më njëzetepesëlekëshe! Gjeje Sokrat, tu bëfsha!

— Peqe! — u përgjigjën sazexhijtë. Dhe avazi filloj prapë, më keq se pak më parë.

Krushku Stefan, mbasi e piu rakinë, bëri ashtu si dajkoja. I ngjiti Sokratit monedhën dhe ky e nderoi me dorë.

Rakia doli në qoshen tonë.

— Më gjete, të gjettë e mira! Të dhjetë shëndetet po i përbledh me një, kurse njëzetepesëlekë-

shin s'po e luaj nga vendi, se eşhtë baraz me një ditë pune, — i thashë dajos.

— Rakitë mblidhi si të duash, po njëzetepesëlekëshin nxirre! — tha dajkoja.

— S'i nxjerr kot se i fitoj me djersë! — i thashë. — Kur të m'i japid kot, do t'i shpenzoj edhe unë kot.

— Rakia ime të vazhdoj — urdhroi dajkoja, si dollibash që ishte.

Po, ndërsa rakia vazhdonte lumë, paratë filluan të bëhen rrëke, gjithnjë e më të vogla. Sazexhinxjtë zgurdullonin sytë. Dajkoja ftoi krushkun Stefan, se tek ai i ndezi.

— O krushku Stefan!

— Urdhéro! — u përgjigj ky.

— Do të marrim një vallë rrethçë.

— Qoftë thënë dhe qoftë bërë! — tha krushku Stefan dhe u ngrit. Dhe filloi vallja rrethçë. Dajkos i merreshin këmbët dhe krushkut Stefan i varej koka. Sokrati frynte bulçitë nga sikleti. Paraja kishte shterur. Pa dashur, dajkoja u pengua. Trupi i tij i rëndë u përplas mbi llautkën e Vangjelit dhe këmbët thyen barkun e violinës, ndërsa krushku Stefan u përshëndosh me klarinetën e Sokratit. Halili u ngrit dhe mundohej të ngrinte krushkun Stefan. Sokrati po mbante nofullat me dorë. Dajkoja u ngrit vetë dhe me solemnitet uroi nga zemra:

— Le të na trashëgohet çifti!

— More, ç'goxha dëm u bë?! — tha krushku Stefan, tek pa veglat muzikore të thyera..

— Jo more, s'ka gjë! — tha Sokrati. — Të na trashëgohet çifti! I ka dasma këto, jemi mësuar ne.

— Vërtet, goxha dëm u bë! — i thashë komshiut. — Le që tanë do të prishet dhe dasma...

Mirëpo, për çudinë time, ndoshta dhe të të tjerëve, sazexhinjtë nxorën vegla të tjera dhe vazhduan punën e tyre.

— Paskan marrë vegla rezervë! — thashë.

— Ka shtëpia e kulturës së kooperativës sa të duash... — m'u përgjigj komshiu.

— Pse të kujt janë veglat? — pyeta unë.

— Po të kooperativës, a derëbardh, të kujt!

— Prandaj nuk e bëkan qejfin qeder këta të orkestrës!

— Po ç'kujtovë ti?! tha komshiu.

TË NA RROJË KRYETARI...

Unë, që the ti, Petraq, punoja roje nate në zyrrat e kryesisë. Eh, ç'kanë parë e dëgjuar këta sytë e mi! ... Po, si i thonë llafit, bëj një vesh shurdh dhe një sy qorr dhe shty të shtyjmë! ... E po, dhe dumimi paska patur kufi, o Petraq vëllai, se të shohësh ato (që mos i pafsha më as në ëndërr!) dhe të hesh-tësh qenka gjë e rëndë. Po nejse, unë durova, se «i duruari, i fituari».

E, që të mos e zgjas llafin, një ditë na u bë mbledhja e asamblesë të kooperativës sonë. «A, këtu i të desha!» — thashë me vete. Presidiumi zuri vend dhe mbledhja mori udhë. U ngritën nga dy-tri vetë para meje. Folën, si të thuash, «tre hunjë e një purtekë» dhe kaluan gardhin. Mua s'po më mbante vendi. Sa bëra të ngrihesha unë, kur u ngrit kryetari.

— More shokë, po na kritikoni, more shokë! More, po na shqepni fare, pa frikë, more shokë! T'i rrëhimi problemet me vaj e me uthull, se kështu do të mund të ecim përpara. Se shikoni, shokë, ata shokët që u ngritën, vërtet folën, dhe bravo u qoftë, por anës e anës! Jo, or, shokë, duam të flasim drejt! T'i biem tjetrit drejt e në lule të ballit! Po, po, mendi-

met t'i konkretizojmë me emra! Me emra, shokë, me emra, ndryshe nuk zënë vend kritikat!

«Të lumtë kryetar! — thashë me vete. — Mirë e the!» dhe ngrita dorën.

— Urdhëro! — më tha i deleguari.

— Unë do flas hapur. Llafe të bukura nuk di, ashtu fshatarçe do flas. Që thoni ju, shokë, kryetarin e kemi të mirë, babaxhan fare.

Kryetari vuri buzën në gaz dhe ndezi një cigare nga kutia e komshiut. Unë vazhdova.

— Kryetari ynë është bujar e mikpritës. Më thoni, shokë, cili nga miqtë dhe të njohurit e tij erdhën këtu dhe ai nuk i priti mirë dhe me bujari?

Kryetari buzëqeshi prapë dhe këtë herë vendosi cigaren në cigarishte. Unë prapë vazhdova.

— Bile, kryetari ynë, miqtë, shokë dhe të njohurit i ndan në kategori: kush është për t'i therur qengj, ia ther; kush është për pula të pjekura, i pjek pulë; kush është për raki; ia shtron. Ka të tjerë që janë përrush, përfiq, përdardha ka edhe nga ata që përcillen me një pjatë mana.

Këtë herë kryetari nuk buzëqeshi më, po dha një të kollitur të fortë dhe fshiu hundët me shami. Unë, tashmë i vendosur vazhdova:

— Po do ngrihet ndonjë nga ju, shokë, dhe do të pyesë: «Të kujt ishin këto qëngja e pula që u therren, apo rakia, rrushi, dardhat, bostani, bile dhe manat?» Po të kooperativës, or byrazer, ishin. Pse nga shtëpia do t'i sillte kryetari, a?!

Këtë herë kryetari, mbasi zhvati edhe një cigare tjetër po nga kutia e komshiut, më pa drejt në sy dhe u nxi si fundi i kusisë së qumështit. Unë prapë avazin.

— Ja, më plaçin sytë, — dhe vura dy gishtërinj-

të në sy, — në ju gënjej! I kam parë vetë të gjitha.

— Po, — e aprovoi kryetari, — i ka parë, se ky
është roje natën dhe këto shikon. — Dhe qeshi, po
e qeshura kësaj here ishte therëse.


— Ka patur dhe raste, vëllezër dhe motra, që,
kur ndonjëri nga miqtë, shokët dhe të njohurit e
kryetarit nuk hante sa duhej, se ishte keq nga sto-
maku, kryetari, më bujari, ia jepte pjesën me vete
në makinë. Sipas rastit, shokë, osë më mirë, sipas
sërës: kujt dy kile mish të pjekur, kujt tre kile raki,
kujt dy arka rrush, kujt një arkë pjeshkë, kujt një
thes bostan.

Kryetari uixori nga xhepi i prasëm i pantallo-
nave një defter shkolle dhe filloj të shkruaj. Unë e
kuptova se ma mori era miellin, po i vendosur, tha-
shë «Kur vajti mijë, le të vejë dhe qindi».

— Ama, ky kryetari ynë, kurrë nuk ka qëndruar
vetëm në mes të miqve dhe shokëve të tij. Jo, më
plaçin sytë! Ai merrte edhe dy-tre anëtarë të krye-
sisë, agronomin, se veterineri nuk i shkonte, ndo-
një nga ata të këshillit, brigadjer Saliun, domosdo
edhe përgjegjësin e blegtorisë. Po mirë e ka, mor vë-
llezër! Rakia do dhe muhabet, pa do dhe një këngë
e një valle; pse ngryset nata vetëm duke ngrënë,
e duke pirë?! Hë, si thoni ju?

Kryetari ktheu fletën e fletores dhe vazhdonte
të shënonë. «Jepi kryetar, — thashë me vete, — se
ç'qe për t'u bërë u bë!»

— Ama dhe një gjë duhet të them, shokë, se
kryetari ka luftuar dhëmbë për dhëmbë me shefin
e llogarisë i cili me «kokëfortësinë e tij» nuk i bin-
dej kryetarit për t'i kaluar gjithë këto shpenzime në
llogarinë «humbje-fitime».



Kaç thashë unë dhe u ula në vendin tim, më të cilin kisha plot një orë që isha ndarë.

U ngritën dhe të tjerë e folën dhe kryetari u detyrua t'i pranojë gabimet dhe të zotohej se do të bënte kthesë. Mbledhja mbaroi dhe ne u shpërندamë.

... Natën vonë, kur unë isha në detyrë dhe po kontrolloja prapa zyrave, dëgjova një të bërtitur të fortë: «Roje! O roje!

— Urdhëro!

— Hajde këtu!

— Shkova.

— Ku ishe? — më tha.

E njoha para se t'i afrohesha. Ishte kryetari.

— Ja, matanë, prapa.

— Flije?

— Jo, po kontrolloja.

— More, flije po të them.

— Jo, kryetar!

— Mor, po thuaj flija.

— Jo, jo, bëja kontroll se ndjeva zhurmë, po paskeni qenë ju.

— Lëri llafet, lëri! Pa më thuaj, ajo dritarja e administratës pse është e hapur?

— E kanë harruar duket!

— Po ti, mor..., çfarë ruan, pulat dhe qengjat që theren, rakinë që pihet, rrushin... — E m'i numëroi një nga një kryetari të gjitha ato që i thashë unë në mbledhje. Helbete, i kishte mbajtur shënim...

— Nesër, — më tha, — në brigadën e Stefanit.

Nuk do të merremi me ty ne!

«Hajde, hajde! — thashë me vete. Bukur ma pu-

nove, se brigada e Štefanit punon në sektorin më të largët, por mos kujto se do të të ecë?»

Dhe vërtet, të nesërmen takova sekretarin e partisë, shokun Sali, dhe i tregova fill e për pe çfarë më ngjau natën e kaluar.

— Mirë, mirë... — tha sekretari. Kthehu dhe shko pusho, se të duhet të jesh prapë roje sonte! Po shkoj unë tek kryetari.

Dhe, që nga ajo ditë, s'më ka rënë më njeri në qafë. Edhe kryetari ynë, ndonëse s'është më kryetar, se e prishi dreqi për pesë para spec, bëri kthesë.

SHOKU ZEQO SHKOI MË POSHTË

Ne jemi tre drejtorë ndërmarrjesh. Që të tre shokë. Më i vjetri nga ne, Saliu, ka disa dekada që drejton një ndër ekonomitë më të mëdha të rrëthit dhe puna i shkon mbarë e mirë. Pas tij vjen Caci, jo vetëm nga mosha, por edhe nga pozita shoqërore. I fundit jam unë, Elmazi. Doemos, mua më takon të rri vazhdimisht me ta, sepse dua të mësoj nga përvoja e punës së tyre, por edhe ata ama më duan shumë dhe më mbajnë afër. Ndonëse jam i ri, edhe nga mosha, dhe në detyrë, ata më konsiderojnë si shok të afërt.

Një mbasdite kishim dalë nga një mbledhje që u zhvillua në komitetin ekzekutiv dhe shkuam të pimin kafe.

Zumë vend në një tryezë katërshe, kështu që, vetëkuptohet, njëra karrige mbeti bosh. Pikërisht kjo karrige u bë shkak për bisedën që do të tregoj.

— Eh, — tha Caci, — në këtë karrige do të rrinte Zeqoja!

— Hë de! — tha Saliu.

— Vërtet, — tha Caci, — nuk u muarr vesh puna e Zeqos! Pse shkoi më poshtë?!

— S'e ke marrë vesh ti, kurse unë e di, — tha
Saliu — Po ti Elmaz e di? — më pyeti ai mua.

— E di, — i thashë.

— E përsë?! — më pyeti pak me shpoti Caci.

— Sepse nuk lexonte gazetën, — u përgjigja unë.

— Jo, mor çun! — më tha Caci. — Si qenka
kështu?! Nuk lexoke gazetën dhe shkoke më poshtë!...
Ja, fjala vjen, po të mos e lexoj dhe unë dhe çfarë?...

— Po dhe ty nuk do të të bënин krushk — u përgjigj Saliu dhe vazhdoi:

— Të bind unë tashti? Gazeta është ushqim për
njeriun, apo jo?

— Po.

— Atëherë?

Këtu hyra unë në muhabet e thashë:

— Një ditë gazeta kishte botuar një fejton ku
kritikonte ndërmarrjen që drejtonte Zeqoja, lidhur
me fatin e shpikjeve dhe propozimeve të punëtorëve
të kësaj ndërmarrjeje. Gazetari, një djalë i ri, ishte
shqetësuar se si do të reagonin lexuesit, punëtorët e
ndërmarrjes e veçanërisht shoku Zeqo. Gazetari u
interesua tek një që punonte në atë ndërmarrje dhe
që ishte bashkëpunëtor i gazetës.

— E mo Petro, ç'tha shoku Zeqo për fejtonin?

— Nuk e ka lexuar fare! — qe përgjigjur Petroja.

— Është e pamundur! — kishte thënë gazetari.

— Drejtor ndërmarrjeje të mos lexojë shtypin!

— Unë të them që nuk është abonuar fare! ...

— A ka mundësi që të ketë drejtues të ekono-
misë sonë që të mos jenë abonuar në shtyp?! — pyeti
gazetari.

— Ja që ka! — i kishte thënë Petroja, — ndo-
nëse janë si qimet e qerosit.»





Mbas disa ditësh në një mbledhje që komiteti organizoi me drejtore të ekonomisë dhe kuadro të tjera lidhur me problemin e shpikjeve e racionalizimeve u kritikua ashpër edhe Zeqoja. Ti s'ishte këtu, ishe me shërbim. Mirëpo Zeqoja, jo vetëm që nuk pranonte asgjë, po ngulte këmbë si kafsha mbi urë e thoshte se nuk ishte e vërtetë që gazeta ta kishte kritikuar ndonjëherë.

«E, — i kishte thënë Petroja gazetarit, — po tani bindesh?

— Bindem, — qe përgjigjur gazetari.

— E ke lexuar gazeten? — kishte pyetur ai që drejtonte mbledhjen.

— Posi ore jo, rresht për rresht bile!

— Dhe nuk e ke parë artikullin që bën fjalë për ty?!

— Nuk e kam parë se nuk ka artikull të tillë!

— E kuptova... — kishte thënë drejtuesi i mbledhjes. — Tani po ta them se fejtonin e ke sa një çarçaf dhe gazetarin, që e ka shkruar, e ke këtu në sallë. Zeqoja kishte ulur kokën poshtë e më poshtë...»

— E, o Caci, — i tha Saliu, — bindesh tani pse shkoi Zeqoja poshtë e më poshtë?...»

— Turp të ketë! — tha Caci. — Kuadër i vjetër...

— I vjetër, i vjetër, po koha të lë në bisht të karrocerisë, në qoftë se nuk ecën me të. Prandaj, edhe ne të dy që jemi pleq, edhe Elmazi që është djali ynë duhet të lexojë e të studjojë më shumë...»

PASQYRA E LËNDËS

Kur shkoi gruaja me shërbim	3
Vendimi	10
Dënimet në mungesë	15
Kasapi i lagjes sime	22
Festa e kuajve të rinj	27
«Padrejtësitë» e arbitrit	33
Në shtëpi mysafir, në lagje radio pazari	37
Mos na ngatërrro me punëtorët	42
Mua të më rrojë përgjegjësi	47
C'kam parë sot, mos pafsha më as nesër dhe as kurrië.	52
Pse e zuri gripi shefin	56
Nuk prishet dasma për një «limon»	60
Të na rrojë kryetari	65
Shoku Zeqo shkoi më poshtë	71